



euralb
WEB HOSTING & SOLUTIONS



Autostrada Tiranë – Durrës, km 12, përballë
Citypark, 1053, Vorë, Tiranë, Shqipëri



+355 696000010



info@euralb.com



www.euralb.com

AKT THEMELIMI i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Euralb Online SH.P.K

Në Tiranë, sot me datë 17/04/2020, unë, Z. Enea Xhani, shtetas Shqiptar, lindur në Librazhd me dt.30.04.1995, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr personal J50430042N, mbështetur në legjislacionin shqiptar në fuqi, themelon këtë Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar në bazë të dispozitave të mëposhtme:

NENI 1 **EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- a. Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është **Euralb Online SH.P.K.**

NENI 2 **FORMA LIGJORE**

- a. Shoqëria **Euralb Online SH.P.K.**, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur si “Shoqëria”).
- b. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
- c. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara nga ky Statut dhe Akti i Themelimit të saj.

NENI 3 **ORTAKU THEMELUES**

- a. Shoqëria Euralb Online SH.P.K themelohet nga Ortaku i Vetëm z. Enea Xhani, shtetas shqiptar, lindur në Librazhd me dt. 30.04.1995, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr personal J50430042N.
- b. Ortaku i Vetëm ushtron kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.



euralb
WEB HOSTING & SOLUTIONS



Autostrada Tiranë – Durrës, km 12, përballë
Citypark, 1053, Vorë, Tiranë, Shqipëri



+355 696000010



info@euralb.com



www.euralb.com

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

- a. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Autostrada Tiranë – Durrës, km 12, përballë Citypark, Godina 4, 1053, Vorë, Tiranë, Shqipëri.
- b. Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 5 OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë Euralb Online SH.P.K është:

Ofrimi i shërbimeve në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Telekomunikacionit dhe Rrjeteve Kompjuterike; Planifikimi dhe Krijimi i parqeve të Qendrave të Dhënave apo Datacenter-ave për interesa të shoqërisë; Servera të Dedikuar, Menaxhimi, Mirëmbajtja e Serverave, tregtimi i tyre dhe dhënia me qira; Servera Virtual Privat; Web Hosting; Reseller Hosting; Email Hosting; Business Email Hosting; Aplikim i teknologjisë Cloud, Cloud Server, Cloud VPS, Cloud Hosting; Çertifikata Sigurie SSL; Shërbime IT dhe Dixhitale për shoqëritë brenda dhe jashtë vendit; Menaxhim i IP-ve (Adresave Numerike), Shitje, Qira; Rrjete Virtuale Private; Kolokimin e të dhënave; Sigurimin e proceseve kompjuterike dhe shërbime për mbrojtjen e të dhënave; Zgjidhje dhe Ndertime të rrjeteve të telekomunikacionit, servera dhe webserver, rrjete intranet extranet; Programe, Software, Liçenca; Regjistrim, Menaxhim, Fshirje të Domaineve .al .com.al .org.al .net.al .edu.al .mil.al .gov.al .com .net .org .info .co .me dhe të gjithë domaineve të tjerë që janë të lejuara ligjërisht për regjistrim, përfshirë domainet kombetare dhe ndërkombetare; Blerje, shkëmbim, marrja ose dhënia me qira e pasurive të paluajtshme për zhvillimin e aktivitetit; Tregtim, blerje, shitje, rishitje, dhënie me qira të produkteve dhe shërbimeve të shoqërisë drejt individëve dhe subjekteve tregtare dhe jo tregtare brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; Dhënie me qira e objekteve për përdorim personal ose shtëpiak; Mirëmbajtje teknike për servera, webhost, faqe interneti, rrjete kompjuterike, pajisje kompjuterike dhe elektronike, programe dhe sisteme informatike etj; Përfaqësi të kompanive të huaja, për produktet apo shërbimet të cilat lidhen direkt apo indirekt me Shoqërinë; Për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si edhe të bleje dhe shese ose marre me qira ndermarrje, dege ndermarrjesh, si edhe të kete interesa ose pjesëmarrje në tendera dhe ankande, ente, konsociume, të themeluara apo në themelin e



euralb
WEB HOSTING & SOLUTIONS



Autostrada Tiranë – Durrës, km 12, përballë
Citypark, 1053, Vorë, Tiranë, Shqipëri



+355 696000010



info@euralb.com



www.euralb.com

siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise; Kontraktim, marrja apo dhenie ne lidhje me fushen e veprimtarise se saj te cdo lloj kreditimi me afat te shkurter te mesem apo te gjate ne tregjet e brendshme apo te jashtme, te mundesoje kredi mallrash, pengjesh, importimi dhe eksportimi; Te perfitoje, transferoje, te marre me qira, te bleje dhe te shese, si dhe te kontraktoje te drejten e markes , patentes, licenses dhe te drejta te tjera qe jane te ngjashme me keto; Me ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje gdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar ne fuqi;

NENI 6 KOHËZGJATJA

- a. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë kohore të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
- b. Afati i përmendur në pikën a të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë, në përputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqërisë.

NENI 7 KAPITALI I SHOQERISE

- a. Kapitali themeltar i Shoqërisë Tregtare **Euralb Online SH.P.K** është 4,880,000 (katërmiljon e tetëqind e tetëdhjetëmijë) Lekë.
- b. Kapital themeltar është i ndarë në 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është 4,880,000 (katërmiljon e tetëqind e tetëdhjetëmijë) Lekë.
- c. Ortaku i vetëm është zotëruesi i të gjitha kuotave të shoqërisë, në vlerën 100% të tyre.
- d. Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.
- e. Cdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.
- f. Kontributi është i llojit PARA dhe është i shlyer.

**NENI 8
DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

- a. Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori.
- b. Administrator i parë i shoqërisë Euralb Online SH.P.K është Z. Enea Xhani

**NENI 9
SHPERBERJA DHE LIKUJDIMI**

- a. Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarë do shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

NENI 10

Ky Akt Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar Euralb Online SH.P.K përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe, të cilat nënshkruhen rregullisht nga ortaku i vetëm.

Ortaku i Vetëm

Z. ENEA XHANI

Enea Xhani
